


Nr.regj:24889/2011



GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINE, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Blerina Berisha, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 dhe 2 i sanksionuar me nenin 16 par 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73, 74, dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 05,12.2011 merr këtë:

AKTVENDIM

E PANDEHURA: Blerina Engjell Berisha, i lindur me 02,04,1975 ne Prizren ,me vendbanim ne Prishtine lagja "Dardania" SU 1/1 hy.2 nr.6,e pa martuar ,ka te kryer fakultetin,punon si Kryesuese e Komisionit te Kosoves per Evaluimin e Produkteve Medicinale, dhe jeton ne gjendje te mesme ekonomike.

Esh te pergjegjese

Sepse ne cilesine e zyrtares se larte si Kryesuese e Komisionit te Kosoves per Evaluimin e Produkteve Medicinale , nuk e ka bere deklarimin e pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit,ne afatin e parapare ligjor gjegjesisht deri me daten 31.03.2011. Me veprim te ketille ka kryer kundervajtje nga neni 6 par 1 dhe 2 i sanksionuar me nenin 16 par.1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, andaj per kete,

GJOBITET

Me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave te KGJK-se, No.1000 4300 7000 0518.Pagesa behet ne ndonjeren agjensi per mbledhjen e te hyrave -banke,permes urdherpageses te plotesuar nga gjykata .Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime te procedures nuk ka patur,kurse ne emer te paushallit gjyqesor i pandehuri eshte i obliguar te paguaje shumen prej 5(pese) €,ne sherbimin e arkes se gjykates. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsy etim

Agjensia Kunder Korrupsionit,Prishtine parashtroi kërkesen me nr.01/3222/11 më dt. 19.07.2011 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Ne baze te kerkeses se parashtuar u inicua procedura kundervajtese me marrjen ne pyetje te pandehuren ,e cila deklaroi se nuk ka qene e njoftuar lidhur me obligimin e deklarimit te pasurise dhe shton se gjate kohes sa eshte dashur qe ta kryeje kete obligim per nje kohe te caktuar ka qene pushim mjekësor. Ne baze te te dhenave ne kerkese,deklarates se te pandehurit, shiqimit te shkresave te lendes dhe provave tjera te administruara gjate procedures, ne mase te mjaftuar u konstatua se e pandehura e ka kryer kundervajtjen e cila me kerkese i vihet ne barre,per çka u shpall pergjegjese dhe u denua me gjobe si ne dispozitiv te ketij aktvendimi .

03-1728/2012/02
f.e.u.

Me rastin e shqiptimit te denimit ,konform nenit 7 te LMK,se ,u moren parasysh te gjitha rrethanat e kryerjes se kundervajtjes,dhe te pandehures iu shqiptua denimi me gjobe ne lartesine si ne diapozitiv te ketij aktvendimi ,duke konsideruar se edhe me kete do te arrihet efekti i sanksionimit ,ashu qe e pandehura ne te ardhmen t'u shmanget kryerjes se veprave te tilla apo te ngjashme kundervajtese .

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të ketij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër ketij aktvendimi, ankesë mund të parashtrijë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës,Gjykates se Larte per Kundervajtje, në afatin prej 8 ditësh,pas marrjes se ketij aktvendimi,nepermes kesaj gjykate dhe pa taksa

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Gjyqtarja
Zajrete Muhaxheri

